



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr

**VENDIM
PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES**

**Neni 1
Përbërja**

Me këtë Vendim formohet grupi punues për zbatimin e programit për vendosjen e rendit komunal për shërbime publike – hapësirave të hapura publike në Komunën e Lipjanit i cili projekt do të përkrahet nga Demos (në vazhdim të tekstit grupi punues) në përbërje si vijon:

- 1.Imer Rrustemi, Drejtor i Drejtoratit për Inspektorat, Kryesues
- 2.Valzim Mziu, Drejtorati për Shërbime Publike, anëtar
3. Venera Haziri, Drejtorati për Inspektorat, anëtar
4. Hashim Berisha , Stacioni policor, anëtar
5. Hajdin Rexhepi, Gjykata Themelore – dega në Lipjan, anëtar
6. Xhelal Krasniqi, Kompania Regjionale e mbeturinave "Pastrimi"
7. Elmi Bublica, Kompania e Ujësjiellësit rajonal "Prishtina"
8. Besim Azemi , Udhëheqës i komunitetit të lagjes
9. Blerim Llugiqi, Udhëheqës komunitetit të lagjes
10. Adil Shamolli, OJQ - Handikos
- 11.Bukurie Zejnullahu, Zyra per informim
- 12.Avni Ramadani, Ekspert për mbeturina

**Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e grupi punues**

Struktura dhe udhëheqja e GP

Rolet dhe përgjegjësitë:

Grupi punues përkatësisht Kryesuesi i grupit punues është përgjegjës për thirrjen e takimeve dhe për udhëheqjen e Grupit punues në arritjen e rezultateve specifike që përshkruhen në takimin e lansimit të projektit.

Kryesuesi duhet të jetë drejtpërdrejt përgjegjës për zbatimin e ligjit/vendosjen e rendit komunal, të demonstrojë udhëheqje të fuqishme dhe të shfaq interes në zbatimin e ligjit.

Kryesuesi duhet të raportojë rregullisht tek GD dhe Komiteti për Shërbime Publike mbi progresin e projektit dhe të ofrojë informata kthyesë për grupin punues.

Anëtarët e grupit punues duhet të ofrojnë input të vlefshëm dhe ekspertizë teknike që ndërlidhet me zbatimin e ligjit/vendosjen e rendit komunal. Anëtarët do të marrin pjesë në mënyrë aktive në takimet e grupeve dhe vizitat studimore, të bashkëpunojnë nga afër me DEMOS-in dhe ekspertët e tij lokalë në veçanti, të angazhohen vullnetarisht dhe të përmbushin detyra specifike në grup.

Neni 3 **Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e Grupit punues si dhe autoritetet e Demos.

1Nr.352-46726

Lipjan, më 23.08.2016

